



Save the Children

# PLANIFIKIMI I ORGANIZIMEVE ME FËMIJË

Një udhëzues i shkurtër i  
Nëntë Kërkesave Themelore



# PLANIFIKIMI I ORGANIZIMEVE ME FËMIJË

Seria e Kërkesave Themelore përbëhet nga udhëzuesit për reference të shpejtë për proceset kryesore që përfshijnë fëmijët. Këta udhëzues nuk janë gjithëpërfshirës dhe nuk duhet përdorur si zëvendësim për politikat më të detajuara dhe procedurat që lidhen me mbrojtjen e fëmijës dhe pjesëmarrjen kuptimplotë dhe etike të fëmijëve.



Ky udhëzues është hartuar për të rriturit që planifikojnë një ngjarje dhe dëshirojnë t'i angazhojnë fëmijët në këtë proces.

## Planifikimi paraprak

Përpara se të komunikon drejtpërdrejt me fëmijët/partnerët/zyrën vendore...

- ✓ Përcaktoni mundësinë
  - Përfshirë: kornizën kohore, draft agjendën, pjesëmarrësit, temat që do të diskutohen, etj. (kështu që zyra vendore/partnerët/fëmijët mund të marrin një vendim të bazuar për përfshirjen e tyre)
- ✓ Theksoni përfitimet e mundshme për fëmijët dhe komunitetet e tyre
  - Si do t'i avancojë kjo ngjarje agjendat dhe objektivat ekzistuese të fëmijëve?
- ✓ Përshkruani se cilat burime do të jenë në dispozicion (njerëzore dhe financiare)
  - Merrni parasysh koordinimin, përkthimin, udhëtimin, vizat, shoqërimin e të rriturve, mbrojtjen e fëmijëve, etj.
- ✓ Ndani detajet e mësipërme me partnerin/zyrën vendore/fëmijët dhe ftojini ata të ndihmojnë në përcaktimin e procesit në më shumë detaje

## Planifikimi

Së bashku me zyrën vendore/partnerin ...

- ✓ Eksploroni nëse ka fëmijë/grupe fëmijësh që mund të jenë të interesuar për ngjarjen
  - Merrni parasysh: aftësitë e nevojshme, gatishmërinë e fëmijëve, rëndësinë, prioritetet e fëmijëve, përfitimet për fëmijët, rrezikun
- ✓ Ndërmerrni një strategji të vlerësimit të rrezikut dhe zbutjes me një person përgjegjës për mbrojtje
- ✓ Sigurohuni që kjo ngjarje të mos jetë një proces "i njëhershëm" dhe që të lidhet me përpjekjet/programet/avokimin afatgjatë për të mbështetur pjesëmarrjen e fëmijëve; përcaktoni qartë 'çfarë do të ndodhë' pas ngjarjes



**Save the Children**

- ✓ Filloni t'i eksploroni të gjitha opsionet që fëmijët të jenë 'prezent' në ngjarje
  - Pjesëmarrja fizike nuk është gjithmonë alternativa më e mirë. Eksploroni të gjitha opsionet duke përfshirë artin, videot, lidhjet në ueb, etj. Inkurajoni inovacionin. Merrni parasysh ndikimin e ngjarjes, kohëzgjatjen e ngjarjes, kostot, mbrojtjen, kohën e fëmijëve/angazhimet e tjera, opinionet/idetë e vetë fëmijëve.
- ✓ Filloni të zhvilloni një plan/strategji të detajuar për pjesëmarrjen e fëmijëve
  - Plani duhet të përfshijë përpjekjet për të përmbushur secilën nga Nëntë Kërkesat Themelore për pjesëmarrjen e fëmijëve
  - Planifikimi dhe përgatitjet 'para' ngjarjeve, duke përfshirë: përgatitjen e informacionit të përshtatshëm për fëmijët (format WORD dhe/ose PPT), përkthimi në gjuhët lokale; punëtori/konsultimet/planifikimi në komunitet me fëmijët; ditët e përgatitjes para ngjarjes
- ✓ Konfirmoni materialet dhe burimet e nevojshme të financimit

## Përzgjedhja

Frymëzimi për të vlerësuar se cilët fëmijë mund të marrin pjesë në një ngjarje...

- ✓ Duhet të punojmë me fëmijët që marrin pjesë në iniciativa/rrjete/projekte të vazhdueshme lokale
- ✓ Fëmijët në projekt duhet të marrin një ftesë dhe të vendosin se si/nëse dëshirojnë të angazhohen
- ✓ Informacioni në lidhje me ngjarjen duhet të jetë i përshtatshëm për fëmijët dhe në një gjuhë dhe format që fëmijët mund ta qasin lehtë
- ✓ Fëmijët duhet t'i përcaktojnë 'kriteret' dhe të vetëzgjedhin/emërojnë përfaqësuesit e tyre
- ✓ Fëmijët duhet t'i përcaktojnë Termat e Referencës për përfaqësuesit e tyre, duke përfshirë kornizën kohore dhe mënyrën se si mund të zgjidhen fëmijë të ndryshëm për ngjarje të ndryshme
- ✓ Në mënyrë ideale, të paktën dy fëmijë mund të emërohen (në mënyrë që ata të mund të mbështesin njëri-tjetrin)
- ✓ Kur është e mundur, (d.m.th. më shumë se një ngjarje) mundësitë duhet të ndahen mes fëmijëve të ndryshëm; inkurajohet mentorimi i kolegëve
- ✓ Gjuha dhe aftësia nuk duhet të jenë kurrë pengesa për pjesëmarrje

## Planifikimi me Fëmijët

- ✓ Përfshini fëmijët në planifikim që në fazën më të hershme të mundshme
  - Fëmijët duhet të ndihmojnë në përcaktimin e agjendës dhe roleve të tyre gjatë ngjarjes; eksploroni Nëntë Kërkesat Themelore dhe planin e përgjithshëm sa më shpejt të jetë e mundur
- ✓ Përditësoni dhe rishikoni vlerësimin e rrezikut së bashku me fëmijët
- ✓ Eksploroni të gjitha opsionet që fëmijët të jenë 'të pranishëm' në ngjarje
  - Pjesëmarrja personale nuk është gjithmonë alternativa më e mirë. Eksploroni të gjitha opsionet duke përfshirë artin, videot, lidhjet në ueb, etj. Merrni parasysh ndikimin e ngjarjes, kohëzgjatjen e ngjarjes, kostot, mbrojtjen, kohën e fëmijëve/angazhimet e tjera, opinionet/idetë e vetë fëmijëve



## Koordinimi

Gjërat kryesore që duhen marrë parasysh gjatë procesit...

- ✓ Personat përgjegjës për mbrojtje të fëmijëve duhet të përcaktohen dhe të angazhohen në fazën më të hershme të mundshme
- ✓ Sigurohuni që fëmijët të kenë mbështetjen dhe mirëkuptimin e komunitetit të tyre, duke përfshirë mësuesit, kujdestarët, prindërit, drejtuesit e komunitetit, fëmijët e tjerë, etj.
- ✓ Zhvilloni një plan të detajuar për t'i ndihmuar fëmijët të përgatiten për ngjarjen. Kjo mund të përfshijë takime përgatitore me fëmijët; konsultime me komunitetin; zhvillimi i udhëzuesve dhe informacioneve të përshtatshme për fëmijët; etj.
- ✓ Sigurohuni që organizatorët e ngjarjes të jenë të ndjeshëm ndaj fëmijëve në ngjarje dhe të kenë njohuritë dhe aftësitë për të planifikuar një proces mbështetës, respektues dhe kuptimplotë (shih udhëzimet tek 'Moderimi i Organizimeve me Fëmijë')
- ✓ Bëni plane të qarta për të mbështetur nevojat e fëmijëve për përkthim dhe/ose nevojat e qasjes
- ✓ Sigurohuni që të ketë plane për t'i mbështetur fëmijët para, gjatë dhe pas ngjarjes. Identifikoni personat kryesorë me këtë përgjegjësi
- ✓ Sigurohuni që përkthyesit, të rriturit/shoqëruesit të kenë udhëzime të qarta dhe t'i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre
- ✓ Vlerësoni procesin me fëmijët, dhe zbatoni mësimet në proceset e ardhshme

